



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. Regj 198

Nr. Vendimi 1248

V E N D I M

“Per regjistrimin si person juridik”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e perbere prej:

GJYQTARE-BRUNILDA KADI

Sot me date 19.04.2018, perfundoi çeshtjen civile, qe i perket:

KERKUES: Kristina Qirici, e bija e Rodolfit, e dtl 10.06.1989, lindur ne Kucove e banues ne Tirane, me cilesine e Drejtorit Ekzekutiv te Qendres "BE THE CHANGE".

OBJEKTI: Regjistrim si Person Juridik i Qendres “BE THE CHANGE”

BAZA LIGJORE: Ligji 7850 date 29.07.1994 i Kodit Civil; Ligji nr.8788 date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimpruese" Ligji Nr 8789 date 07.05.20101 “Per regjistrimin e organizatave jo Fitimpruese” Ligj Nr. 79/2017 “Per Sportin”

V E R E N

Themeluesit e Qendres “BE THE CHANGE”, bazuar ne legjislacionin shqiptar dhe kerkesat e Ligjit Nr. 8788 date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimpruese” kanë hartuar, miratuar dhe legalizuar aktet e nevojshme per regjistrimin e saj si Person Juridik, ne formen e Qendres. Pasi shqyrtova materialet e paraqitura, verejta se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PËR KËTO ARËSYE

Ne zbatim te Ligjit nr. 7850 date 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikes se Shqiperise”, Ligjit Nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” dhe Ligjit Nr. 8789, date 7.5.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”

V E N D O S A

-Pranimin e kerkeses dhe regjistrimin e organizates jofitimpruese, Qendres “BE THE CHANGE”, si person juridik shqiptar në Regjistrin e Organizatave Jofitimpruese prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

- Themelues te Qendres "BE THE CHANGE" janë:

1. Kristina Qirici, e bija e Rodolfit, e dtl 10.06.1989, lindur ne Kucove e banuese ne Tirane, mbajtëse e laternjofimit me nr. personal I95610070G.

2. Eleni Moraiti Bajraktari, e bija e Kostandinos, e dtl 18.04.1989, shtetase greke, lindur ne Holargos –Papagu, Greqi dhe banuese ne Athine, Greqi, me karte identiteti greke me nr. AI961332.

-Qellimi e kesaj Qendre eshte edukimi ne fushen e psikoterapise dhe keshillimit shkencor ne fushen e aplikimit te teorise psikoterapike ne shendetesi, ne arsim dhe orientimin e psikologeve, punjonjesve sociale , infermiereve te psikiatrive dhe tre shkencave te tjera, etj.

-Selia e Qendres "BE THE CHANGE" eshte: Rruga e Kavajes, Pall SPEED, kat I pare, sa Tirane, Shqipëri.

-Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së Qendres "BE THE CHANGE" eshte e pacaktuar.

-Organet Drejtuese te Qendres "BE THE CHANGE" jane:

1. Bordi i Drejtoreve.

2. Drejtori Ekzekutiv

Bordi i Drejtoreve i Qendres perbehet nga :

1. Kristina Qirici

2. Eleni Moraiti Bajraktari


3. Asimina Chioni

Drejtori Ekzekutiv - Kristina Qirici.

Tirane me date 19.04.2018

**GJYQTAR
BRUNIDLA KADI**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Nr.Regj. 817
Data e Regjistrimit 24.05.2023

Nr. Vendimi 1248/6
Data 08.06.2023

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË, E PERBERE NGA:

Niko RAPI – GJYQTAR

Sot më datë 08.06.2023, perfundova ne shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën qe i përket:

KERKUES:

Kristina Qirici, shtetase shqiptare, e dtl. 10.16,1989, lindur në Kucovë, madhore dhe me zotesi te plote juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034326436, dhe nr. personal I95610070G.

OBJEKTI:

Depozitimi në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Vendimit të Bordit Drejtues të Qendrës "Be the Change".

BAZA LIGJORE:

Nenet 8, 17/1 dhe 18 të Ligjit Nr.80/2021 "Per Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", nenet 20, 22, 24 të Ligjit 8788, datë 7.5.2001 "Per Organizatat Jofitimprurëse"

VËREN:

Qendra "Be the Change" është një organizatë jofitimprurëse, e cila është regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me Vendimin nr.1248, datë 19.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe ushtron veprimtarinë me seli në adresën Rruga e Kavajes, Pall. SPEED, kati i parë, Tiranë, Shqipëri.

Nga ana e kërkuarit është paraqitur kërkesa për depozitimin e Vendimit datë 22.05.2023 të mbledhjes se Bordit Drejtues të Qendrës "Be the Change".

Konkretisht në mbledhje kanë marrë pjesë anëtarët: Stela Kumati, Eleni Moriati Bairaktari perf me prokure te posacme nga Kristina Qirici, Julian Leskaj, Kristina Qirici.

Në mbledhje është vendosur:

- Miratimi i ndryshimeve në Statutin e Qendrës siç është i bashkëlidhur me kërkesën për depozitim.

Kjo vendimmarrje është marrë në përputhje me ligjin Nr.8789 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse dhe nenit 8 të Statutit të Qendrës.

Pasi u administruan regjistrimet e mëparshme lidhur me Qendrën, gjykata vëren se formalisht kërkesa është e rregullt dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 24-53/1 te Kodit Civil, ligji Nr.8788, date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimprurese", ligji Nr.8789, date 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese";

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të Vendimit datë 22.05.2023 të Bordit Drejtues të Qendrës "Be the Change" për miratimin e ndryshimeve të Statutit.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrimit të OJF-ve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kryejë veprimet përkatëse për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës kërkuese.

U shpall ne Tirane, me date 08.06.2023!

**GJYQTAR
NIKO RAPI**



Tarifë gjyqësore (parapaguar) 1000 leke